



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 3153 / prot.
/3

Elbasan, me 28.12.2023

VENDIM

Nr 52 , datë 28.12.2023

**PËR
PAGESËN HONORAREVE TË DISA KOMISIONEVE NË UE**

Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, neni 157, VKM nr. 929 datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", të ndryshuar, VKM nr. 748 datë 11.06.2009 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", i ndryshuar, VKM Nr. 325; date 31.05.2023 , "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civile /nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike", VKM Nr. 326, date 31.05.2023 , "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", VBA nr. 15, datë 03.05.2023 "Për miratimin e nivelit të pagave, për secilin pozicion pune, të personelit akademik në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", VBA nr. 22, datë 29.06.2023 "Për nivelin e pagave të personelit administrativ dhe ndihmësakademik të Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", VBA nr. 23, datë 29.06.2023 "Për nivelin e pagave të personelit mbështetës në Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", Bordi i Administrimit

VENDOSI:

1. Punonjësit e Universitetit, që me vendim, ose urdhër të organeve apo autoriteteve drejtuese: Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektori i Universitetit, Administratori i Universitetit, angazhohen në procese të caktuara pune, që nuk lidhen me veprimtarinë e përditëshme apo detyrave funksionale të njësive të UE-së , të paguhen me honorare në masën e një pagë mujore për çdo rast, por jo më shumë se dy paga mujore në një vit. Rastet e komisioneve dhe grupeve të posaçme të punës të jenë, si më poshtë:
 - Anëtarët e komisioneve të ngritura me akte të posaçme, apo punonjës të ngarkuar në kryerjen e proceseve zgjedhore në UE.
 - Anëtarët Këshillit të Etikës në UE,
 - Anëtarët e komisionit "Ad Hoc", për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave të studentëve të Ciklit të parë të studimeve Bachelor, të studentëve në programet me karakter profesional, të studentëve në programet e integruara, që plikojnë për përfitim burse financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit në çdo vit akademik,



- Anëtarët e komisionit “Ad Hoc”, për procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave të studentëve të Ciklit të dytë të studimeve Master, që aplikojnë për ulje tarife vjetore shkollimi, në çdo vit akademik.
 - Anëtarët e komisionit të konkursit të pranimit në programin bachelor në edukim fizik dhe sporte, apo punonjës të ngarkuar me procese pune në funksion të procesit të konkurimit.
 - Anëtarët e komisionit për plotësimin e dokumentacionit shkollor të studentëve të këtij Universiteti, që janë diplomuar para vitit 1997, dokumentacioni bazë për këtë qëllim është djegur gjatë trazirave të atij viti,
 - Anëtarët e komisioneve për procedurat e akreditimit në institucion, apo punonjës të ngarkuar me proceset e akreditimit.
 - Grupet e posaçme të punës për aspekte të ndryshme të aktivitetit të institucionit.
2. Administratori i UE-së të hartojë urdhërin e pagësës së honorareve për secilin punonjës në çdo rast të punës së kryer, duke u bazuar në aktin konkret normativ dhe relacionin e detajuar të veprimtarisë përkatëse.
 3. Në fund të vitit buxhetor Administratori i UE-së informon Bordin e Administrimit në mënyrë të detajuar për pagesat e kryera për secilin punonjës.
 4. Ngarkohet Administratori i Universitetit “Aleksandër Xhuvani” për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT

Ardian Durmishi

